

**VENDIM**  
**Nr. 460, datë 26.7.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.1707, DATË 29.12.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR LËSHIMIN E PATENTAVE PËR SHPIKJET DHE MODELET E PËRDORIMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, 17, 18, 20, 26, 29-31, 34, 35, 49, 50, 70, 75, 87, shkronjat "a"- "g", 97, 99 e 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregulloren "Për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit", që i bashkë-lidhet vendimit nr. 1707, datë 29.12.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në rregullore:

a) Emërtimi "Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave" zëvendësohet me "Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale";

b) Emërtimet "FP1"; "FP2"; "FP3"; "FP4"; "FP5"; "FP6"; "FP7"; "FP8"; "FP9"; "FP10"; "FP11"; "FP12"; "FP13"; "FP14"; dhe "FP15" zëvendësohen me fjalët "... përkatës të aplikimit ...".

2. Në kreun I bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën "e", të pikës 2.1, dhe kudo në rregullore fjalët "... i ndryshuar me ligjin nr. 55/2014 ..." zëvendësohen me "... i ndryshuar.";

b) Pika 4 shfuqizohet.

3. Në kreun II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 1.1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"1.1 Aplikimi për lëshimin e një patente bëhet nëpërmjet formularit përkatës të aplikimit, i cili nënshkruhet nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij dhe depozitohet pranë DPPI-së. Aplikimi për patentë mund t'i dërgohet DPPI-së nga paraqitësi i kërkesës ose përfaqësuesi i tij edhe me postë, me faks ose *on-line* nëse DPPI-ja e ofron. Në rastin e dërgimit me faks, aplikanti duhet që, brenda një muaji nga data e dërgimit të faksit, të depozitojë pranë DPPI-së kërkesën në formën e saj origjinale, në të kundërt kërkesa konsiderohet si e paparaqitur."

b) Pika 1.4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"1.4 DPPI-ja, ditën që merr në dorëzim formularin përkatës të aplikimit për patentë, shënon mbi formular datën, orën e paraqitjes dhe numrin e kërkesës."

c) Pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7, me këtë përmbajtje:

"6. Përmbajtja e kërkesës për hartimin e raportit të kërkimit

6.1 Pas marrjes së numrit të aplikimit dhe datës së depozitimit, aplikanti ose përfaqësuesi i tij mund të depozitojë në DPPI kërkesën për hartimin e një raporti kërkimi nga një zyrë kombëtare ose ndërkombëtare, e cila gëzon statusin e Autoritetit Ndërkombëtar për Ekzaminim Paraprak, sipas nenit 32, të Traktatit të Bashkëpunimit për Patentat, ose nga zyra, me të cilat DPPI-ja ka marrëveshje bashkëpunimi, në mënyrë që të përcaktojë nëse shpikja e paraqitur në aplikimin për patentë plotëson kriteret për patentueshmëri, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar.

6.2 Kërkesa për hartimin e raportit të kërkimit mund të depozitohet në çdo kohë, nëpërmjet formularit të përcaktuar nga zyra dhe të publikuar në faqen e saj zyrtare, në dy kopje identike dhe shoqërohet me pagesën përkatëse për hetim, të përcaktuar nga zyra e zgjedhur prej aplikantit, e cila do të kryejë hetimin, si dhe koston e transferimit të pagesës së raportit të kërkimit.

6.3 DPPI-ja, sipas rastit, mund t'i kërkojë aplikantit të depozitojë përkthimin në gjuhë tjetër të pretendimeve apo dhe të të gjithë përshkrimit të patentës për ta përcjellë atë në zyrën që do të hartojë raportin e kërkimit.

6.4 Kërkesa për hartimin e një raporti kërkimi duhet të përmbajë:

a) Të dhënat e aplikantit (emri i personit juridik, kodi, adresa, kodi shtetëror, emri, mbiemri i personit fizik, adresa, kodi shtetëror, adresa e postës elektronike);

b) Të dhënat e përfaqësuesit, në rast se kërkesa për kryerjen e një raporti kërkimi paraqitet nga

përfaqësuesi i autorizuar (emri i përfaqësuesit të autorizuar, kodi, adresa, kodi shtetëror, adresa e postës elektronike);

c) Statusin e aplikantit;

ç) Të dhënat e aplikimit të mëparshëm, nëse është pretenduar për prioritet;

d) Nënshkrimin e aplikantit ose të përfaqësuesit të tij;

dh) Autorizimin e përfaqësimit, në rast se aplikimi depozitohet nga një përfaqësues i autorizuar.

6.5. Aplikuesi ose përfaqësuesi i tij është përgjegjës për korrektësinë e kërkesës së paraqitur, sipas pikave 6.1 deri në 6.4, të këtij neni, dhe i nënshtrohet të gjitha pasojave që lidhen me informacionin e pasaktë të dorëzuar.

7. Shqyrtimi nga DPPI-ja i kërkesës për hartimin e raportit të kërkimit.

7.1 Pas përfundimit të ekzaminimit për formalitetin aplikimit, për të cilin është kërkuar hartimi i raportit të kërkimit, dhe pas aprovimit nga sektori i patentave se aplikimi përmbush kërkesat formale të ekzaminimit, DPPI-ja e përcjell kërkesën për hartimin e raportit të kërkimit në zyrën e zgjedhur nga aplikanti dhe e informon atë ose përfaqësuesin e tij për këtë fakt.

7.2 Nëse, pas ekzaminimit për formalitetin e aplikimit, për të cilin është kërkuar hartimi i raportit të kërkimit, është marrë vendim nga zyra për refuzimin e aplikimit, DPPI-ja do ta konsiderojë të dorëhequr kërkesën e depozituar për hartimin e raportit të kërkimit, do të njoftojë me shkrim aplikantin dhe do t'i kthejë atij pagesat e depozituara për hartimin dhe transferimin e pagesës së raportit të kërkimit.

7.3 Aplikanti për patentë, për të cilën është depozituar një kërkesë për hartimin e raportit të kërkimit, ose përfaqësuesi i tij, pas marrjes së njoftimit nga DPPI-ja se aplikimi i plotëson kushtet formale për ekzaminim, sipas pikës 7.1, duhet të depozitojë në gjuhën angleze të gjithë aplikimin për patentë (pretendimet, abstraktin, përshkrimin e shpikjes, të dhënat e aplikimit për patentë si dhe vizatimet).

7.4 Aplikanti është përgjegjës për pasojat që rrjedhin nga përkthimi i pasaktë i dokumenteve të aplikimit.”

4. Shkronja “a”, në pikën 2.4, të kreut IV, zëvendësohet me fjalët “... formulari përkatës i aplikimit ...”.

5. Shkronja “a”, në pikën 1.1, të kreut XI, zëvendësohet me fjalët “... formulari përkatës i aplikimit për kundërshtimin e patentës ...”.

6. Pas kreut XIV shtohen krerët XIV/1 dhe XIV/2, me këtë përmbajtje:

#### “KREU XIV/1 E DREJTA E PENGUT PËR PATENTAT E SHPIKJEVE

1. Paraqitja e kërkesës

1.1 Kërkesa për regjistrimin e një kontrate garancie ose pengu për një patentë, parashikuar nga neni 36/a i ligjit, paraqitet pranë DPPI-së nëpërmjet formularit përkatës të aplikimit, me kërkesë të njëjës prej palëve në kontratë. Së bashku me kërkesën, aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

a) Dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse;

b) Autorizimin e përfaqësimit, kur paraqitësi i kërkesës nuk është njëri nga palët në kontratë;

c) Dokumentin që vërteton se kemi të bëjmë me një kontratë garancie ose pengu.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPI-ja

2.1 DPPI-ja shqyrton kërkesën për regjistrimin e kontratës së garancisë ose të pengut nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij kreu, dhe, në rast se ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 muajve nga data e njoftimit. Në të kundërt, kërkesa refuzohet.

2.2 Kur kërkesa për regjistrimin e kontratës së garancisë ose të pengut është në përputhje me parashikimet e pikës 1.1, të këtij kreu, DPPI-ja e regjistron kontratën e garancisë ose të pengut në regjistrin e patentave, njofton aplikantin dhe bën publikimin e saj në Buletinin e Pronësisë Industriale.

#### KREU XIV/2 PROCEDURA PËR ZBATIMIN E VEPRIMEVE PËRMBARIMORE

1. Paraqitja e kërkesës

1.1 Kërkesa për regjistrimin e një veprimi përmbarimor për një patentë, e parashikuar nga neni 36/b i ligjit, paraqitet pranë DPPI-së nëpërmjet formularit përkatës të aplikimit, me kërkesë të njëjës prej palëve në kontratë. Së bashku me kërkesën aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

- a) Dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse;
- b) Autorizimin e përfaqësimit, kur paraqitësi i kërkesës nuk është njëri nga palët në kontratë;
- c) Dokumentin që vërteton veprimin përmbari-mor.

## 2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPI-ja

2.1 DPPI-ja shqyrton kërkesën për regjistrimin e një veprimi përmbarimor, nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij kreu, dhe, në rast se ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 muajve nga data e njoftimit. Në të kundërt, kërkesa refuzohet.

2.2 Kur kërkesa për regjistrimin e një veprimi përmbarimor është në përputhje me parashikimet e pikës 1.1 të këtij kreu, DPPI-ja, me një njoftim zyrtar, njofton, paraprakisht, pronarin e patentës, përpara se të regjistrojë veprimin përmbarimor në regjistrin e patentave dhe të bëjë publikimin e saj në Buletinin e Pronësisë Industriale.”.

7. Në kreun XVI bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- a) Shkronja “b”, e pikës 1.1, shfuqizohet;
- b) Pas pikës 3.5 shtohet pika 3.6, me këtë përmbajtje:

“3.6. Kur pagesa është kryer, por regjistrimi nuk mund të ripërtërihet ose është ripërtërirë si pasojë e një pagese tjetër, kjo pagesë do të rimbursohet nga zyra.”.

8. Shkronja “a”, në pikën 3.1, të kreut XVII, zëvendësohet me fjalët “... formulari përkatës i aplikimit, i nënshkruar nga pronari i patentës ose përfaqësuesi i tij;”.

9. Shkronja “a”, në pikën 1.1, të kreut XVIII, zëvendësohet me fjalët “... formularin përkatës të kërkesës për apelim, të nënshkruar nga pronari i patentës ose përfaqësuesi i tij;”.

10. Formularët “FP1”, “FP2”, “FP3”, “FP4”, “FP5”, “FP6”, “FP7”, “FP8”, “FP9”, “FP10”, “FP11”, “FP12”, “FP13”, “FP14” dhe “FP15” zëvendësohen me formularët që i bashkëlidhen kësaj rregulloreje.

II. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**



**FORMULAR APLIKIMI**  
PËR REGJISTRIMIN KOMBËTAR TË MODELIT TË PËRDORIMIT



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

<b>Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:</b> Tel: +355 (0) 42236288 E-mail: mailinf@alpto.gov.al Web: www.dppm.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
<b>Shënim:</b> Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, <b>ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.</b>	Referenca: Nr i protokollit:

**SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN**

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Emri i Babait	<input type="text"/>	4. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	<input type="text"/>
5. Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>
7. Vendlindja	<input type="text"/>	8. Kombësia	<input type="text"/>
9. Adresa	<input type="text"/>		
10. Qyteti	<input type="text"/>	11. Rrethi	<input type="text"/>
12. Kodi Postar	<input type="text"/>	13. Nr. Tel	<input type="text"/>
14. Adresa për korrespondencë <i>(nëse është e ndryshme nga sa më sipër)</i>	<input type="text"/>		
NESE APLIKANTI ESHTË PERSON JURIDIK			
15. Emri i kompanisë	<input type="text"/>	16. NUIS <i>(Nr. unik i identifikimit të subjektit)</i>	<input type="text"/>
17. Adresa	<input type="text"/>	18. Statusi ligjor	<input type="text"/>

**SEKSIONI A1: INFORMACION MBI PËRFAQËSUESIN E AUTORIZUAR**

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Adresa	<input type="text"/>		
4. Qyteti	<input type="text"/>	5. Rrethi	<input type="text"/>
6. Kodi Postar	<input type="text"/>	7. Nr. Tel	<input type="text"/>
8. Kodi i përfaqësuesit të autorizuar <i>(plotësohet vetëm nga përfaqësuesit e licensuar nga DPPI)</i>	<input type="text"/>		

**SEKSIONI A1: INFORMACION MBI SHPIKËSIN/SHPIKËSAT**

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Adresa	<input type="text"/>		
4. Qyteti	<input type="text"/>	5. Rrethi	<input type="text"/>
6. Kodi Postar	<input type="text"/>	7. Nr. Tel	<input type="text"/>
8. Adresa për korrespondencë <i>(nëse është e ndryshme nga sa më sipër)</i>	<input type="text"/>		

**SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN****LLOJI I APLIKIMIT** **Aplikim për model përdorimi****PRIORITETI/PËRPARËSIA (në rast se pretendohet)** **Paraqitësi i kërkesës pretendon për një mbrojtje prioritare (përparësore) bazuar në një depozitim aplikimi të mëparshëm:****1. Zyra e aplikimit të mëparshëm** **2. Numri i aplikimit** **3. Data e pagesës**   
Data Muaji Viti**TITULLI I MODELIT TË PËRDORIMIT****TË DHËNA NDËRKOMBËTARE TË APLIKIMIT PËR MODEL PËRDORIMI****4. Nr ndërkombëtar i aplikimit** **5. Data ndërkombëtare e aplikimit**   
Data Muaji Viti**6. Nr ndërkombëtar i publikimit** **7. Data ndërkombëtare e publikimit**   
Data Muaji Viti**TARIFAT DHE MËNYRA E PAGESËS** **Tarifa bazë**  **Tarifa mbi çdo pretendim mbi pretendimin e 10 (dhjetë)** **8. Lloji i pagesës** **9. Data e pagesës**   
Data Muaji Viti**10. Totali i shumës së paguar** **SEKSIONI C: PRANIMI I APLIKIMIT**

Shënim: Është përgjegjësi e nënshkruesit të kërkesës çdo mospërputhje e të dhënave të formularit me dosjen e paraqitur

**Shtojca I. Formular i deklarimit të të dhënave personale.**

Unë i/e nënshkruari(a) prano që DPPI mund të më kontaktojë nëpërmjet mjeteve vijuese të komunikimit, për çështje të lidhura procedurat të parashikuara në Ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për Pronësinë Industriale", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:

 **nëpërmjet postës elektronike (e-mail) në adresën:**  **nëpërmjet komunikimit (SMS, telefonatë) në numrin:**  **nëpërmjet fax-it në numrin:**

DPPI njofton se shënimi i të dhënave të mësipërme të kontaktit është vullnetar. DPPI do të ruajë këto të dhëna (në vijim "Të dhënat Personale") që aplikanti dhe/ose personi i autorizuar (në vijim "Subjekti") kanë shënuar në këtë formular aplikimi. Të dhënat personale do të përpunohen e përdoren nga DPPI, në cilësinë e Kontrolluesit, apo nga persona të tretë të caktuar nga DPPI, në cilësinë e Përpunuesit, ekskluzivisht për të komunikuar me subjektin, për sa i përket procedurave të lidhura me këtë aplikim.

Të dhënat personale nuk do t'i kalohen një marrësi të tretë, pa pëlqimin paraprak të subjektit dhe nuk do t'i nënshtrohen transferimit ndërkombëtar.

DPPI mund të përdorë herë pas here një nga format e mësipërme të komunikimit për të kontaktuar subjektin dhe për t'i dërguar informacione që mund të jenë në interes të tij/saj, të tilla si njoftime, ngjarje dhe/ose zhvillime ligjore në fushën e veprimtarisë së DPPI. DPPI do të ndalojë dërgimin e këtij informacioni nëse subjekti njofton shprehimisht me shkrim DPPI-në, se ai/ajo nuk dëshiron të kontaktohet më tej për të marrë informacione të tilla.

Subjekti ka të drejtën e aksesit, bllokimit, korrigjimit ose fshirjes së të dhënave personale që DPPI ka ruajtur në bazën e të dhënave, si dhe të kërkojë të ushtrojë cdo të drejtë tjetër që i njihet nga legjislati në fuqi "Për mbrojtjen e të dhënave personale",

*\* Për çdo informacion shtesë mund të përdorni faqen e fundit.*

#### KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe nga paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi jep pëlqimin që DPPI të ruajë, përpunojë e përdorë të dhënat personale të subjektit, në pajtim me kushtet e mësipërme. Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi gjithashtu deklaron nën përgjegjësinë e tij/saj se të dhënat e kontaktit si më sipër janë të dhënat e tij/saj, ose të një personi të tretë, që ka autorizuar nënshkruenin të kryejë këto veprime.

Nënshkrimi i Aplikantit

(Data)			(Muaji)				(Viti)		

# FAQE SHITESË



## FORMULAR APLIKIMI PËR CERTIFIKATË TË MBROJTJES SHITESË



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

<b>Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:</b> Tel: +355 (0) 42236288 E-mail: mailinf@alpto.gov.al Web: www.dppm.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
<b>Shënim:</b> Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, <b>ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.</b>	Referenca: Data:

### SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Emri i Babait	<input type="text"/>	4. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	<input type="text"/>
5. Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>
7. Vendlindja	<input type="text"/>	8. Kombësia	<input type="text"/>
9. Adresa	<input type="text"/>		
10. Qyteti	<input type="text"/>	11. Rrethi	<input type="text"/>
12. Kodi Postar	<input type="text"/>	13. Nr. Tel	<input type="text"/>
14. Adresa për korrespondencë <i>(nëse është e ndryshme nga sa më sipër)</i>	<input type="text"/>		
NËSE APLIKANTI ËSHTË PERSON JURIDIK			
15. Emri i kompanisë	<input type="text"/>	16. NUIS <i>(Nr. unik i identifikimit të subjektit)</i>	<input type="text"/>
17. Adresa	<input type="text"/>	18. Statusi ligjor	<input type="text"/>

### SEKSIONI A1: INFORMACION MBI PËRFAQËSUESIN E AUTORIZUAR

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Adresa	<input type="text"/>		
4. Qyteti	<input type="text"/>	5. Rrethi	<input type="text"/>
6. Kodi Postar	<input type="text"/>	7. Nr. Tel	<input type="text"/>
8. Numri/Kodi i përfaqësuesit <i>(plotësohet vetëm nga përfaqësuesit e licensuar nga DPPI)</i>	<input type="text"/>		

### SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

#### TË DHËNA TË PATENTËS BAZË

1. Numri i aplikimit kombëtar	<input type="text"/>	2. Numri i patentës bazë	<input type="text"/>
3. Data e grantimit të patentës <i>(në rast se ka)</i>	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>	4. Data e mbarimit të patentës	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>

\* Data e mbarimit të patentës është data para përvjetorit të 20-të të datës së depozitimit.



Kërkesa e pretenduar për një certifikatë mbrojtje shtesë bëhet për:

Produkte mjekësore

Produkte për mbrojtjen e bimëve

**5. Karakteristikat e produktit të cilin dëshironi të mbron**

TË DHËNA NDERKOMBËTARE TË PATENTËS

**6. Numri ndërkombëtar i aplikimit**

**7. Data ndërkombëtare e aplikimit**   
Data Muaji Viti

**8. Numri ndërkombëtar i publikimit**

**9. Data ndërkombëtare e publikimit**   
Data Muaji Viti

NUMRI DHE DATA E AUTORIZIMIT TË PARË PËR HEDHJEN E PRODUKTIT NË TREG

**10. Numri i autorizimit**

**11. Data e lëshimit**   
Data Muaji Viti

**12. Produkti për të cilin është lëshuar autorizimi**

TË DHËNA PËR AUTORIZIMIN E PARË PËR HEDHJEN E PRODUKTIT NË TREG

*(kur autorizimi i depozituar nuk është autorizimi i parë për hedhjen e produktit në treg)*

**13. Numri i autorizimit**

**14. Shtetu ku është lëshuar**

**15. Produkti për të cilin është lëshuar**

**16. Data e lëshimit**   
Data Muaji Viti

**17. Baza ligjore ku është mbështetur procedura e lëshimit të autorizimit të parë**

TARIFA DHE MËNYRA E PAGESËS

**18. Lloji i pagesës**

**19. Totali i shumës së paguar**

**SEKSIONI C: PRANIMI I APLIKIMIT**

Shënim: Është përgjegjësi e nënshkruesit të kërkesës çdo mospërputhje e të dhënave të formularit me dosjen e paraqitur

**Shtojca I.** Formular i deklaramit të të dhënave personale.

Unë i/e nënshkruari(a) pranoj që DPPI mund të më kontaktojë nëpërmjet mjeteve vijuese të komunikimit, për çështje të lidhura me procedurat të parashikuara në Ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për Pronësinë Industriale", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:

nëpërmjet postës elektronike (e-mail) në adresën:

nëpërmjet komunikimit (SMS, telefonatë) në numrin:

nëpërmjet fax-it në numrin:

DPPI njofton se shënimi i të dhënave të mësipërme të kontaktit është vullnetar. DPPI do të ruajë këto të dhëna (në vijim "Të dhënat Personale") që aplikanti dhe/ose personi i autorizuar (në vijim "Subjekti") kanë shënuar në këtë formular aplikimi. Të dhënat personale do të përpunohen e përdoren nga DPPI, në cilësinë e Kontrolluesit, apo nga persona të tretë të caktuar nga DPPI, në cilësinë e Përpunuesit, ekskluzivisht për të komunikuar me subjektin, për sa i përket procedurave të lidhura me këtë aplikim.

Të dhënat personale nuk do t'i kalohen një marrësi të tretë, pa pëlqimin paraprak të subjektit dhe nuk do t'i nënshtrohen transferimit ndërkombëtar.

DPPI mund të përdorë herë pas here një nga format e mësipërme të komunikimit për të kontaktuar subjektin dhe për t'i dërguar informacione që mund të jenë në interes të tij/saj, të tilla si njoftime, ngjarje dhe/ose zhvillime ligjore në fushën e veprimtarisë së DPPI. DPPI do të ndalojë dërgimin e këtij informacioni nëse subjekti njofton shprehimisht me shkrim DPPI-në, se ai/ajo nuk dëshiron të kontaktohet më tej për të marrë informacione të tilla.

Subjekti ka të drejtën e aksesit, bllokimit, korigjimit ose fshirjes së të dhënave personale që DPPI ka ruajtur në bazën e të dhënave, si dhe të kërkojë të ushtrojë çdo të drejtë tjetër që i njihet nga legjislacioni në fuqi "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

#### KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe nga paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi jep pëlqimin që DPPI të ruajë, përpunojë e përdorë të dhënat personale të subjektit, në pajtim me kushtet e mësipërme. Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi gjithashtu deklaron nën përgjegjësinë e tij/saj se të dhënat e kontaktit si më sipër janë të dhënat e tij/saj, ose të një personi të tretë, që ka autorizuar nënshkruesin të kryejë këto veprime.

Nënshkrimi i Aplikantit

--	--	--	--	--	--	--	--

(Data) (Muaji) (Viti)

# FAQE SHITESË



**FORMULAR APLIKIMI**  
PËR APELIMIN E REFUZIMIT TË MODELIT TË  
PËRDORIMIT NË BORDIN E APELIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË



<b>Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:</b> Tel: +355 (0) 42236288 E-mail: mailinf@alpto.gov.al Web: www.dppm.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
<b>Shënim:</b> Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, <b>ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.</b>	Referenca: Data:

**SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APELUESIN**

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Emri i Babait	<input type="text"/>	4. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	<input type="text"/>
5. Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>
7. Vendlindja	<input type="text"/>	8. Kombësia	<input type="text"/>
9. Adresa	<input type="text"/>		
10. Qyteti	<input type="text"/>	11. Rrethi	<input type="text"/>
12. Kodi Postar	<input type="text"/>	13. Nr. Tel	<input type="text"/>
NËSE APLIKANTI ËSHTË PERSON JURIDIK			
14. Emri	<input type="text"/>	15. NUIS <i>Nr. unik i identifikimit të subjektit</i>	<input type="text"/>
16. Statusi ligjor	<input type="text"/>	17 Nr. Tel	<input type="text"/>
18. Adresa	<input type="text"/>		

**SEKSIONI A1: INFORMACION SPECIFIK MBI PËRFAQËSUESIN/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR**

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Adresa	<input type="text"/>		
4. Nr.Tel	<input type="text"/>	5. Fax/e-mail	<input type="text"/>
6. Kodi i përfaqësuesit të autorizuar	<input type="text"/>		

**SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN**

TË DHËNA LIDHUR ME MODELIN E PËRDORIMIT			
1. Numri i aplikimit	<input type="text"/>	3. Data e depozitimit	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>
2.Data e refuzimit të aplikimit	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>		
4. Titulli i shpikjes	<input type="text"/>		

BAZA LIGJORE

--

LLOJI DHE MËNYRAT E PAGESËS

Tarifa për apelimi \_\_\_\_\_ lekë

5. Lloji i pagesës

--

6. Data e pagesës

Data	Muaji					Viti	

7. Mënyra e pagesës

--

SEKSIONI C: NËNSHKRIMI I APLIKUESIT OSE PËRFAQËSUESIT TË TIJ

Shënim: Është përgjegjës e nënshkruesit të kërkesës çdo mospërputhje e të dhënave të formularit me dosjen e paraqitur

**Shtojca I.** Formular i deklarimit të të dhënave personale.

Unë i/e nënshkruari(a) pranoj që DPPI mund të më kontaktojë nëpërmjet mjeteve vijuese të komunikimit, për çështje të lidhura procedurat të parashikuara në Ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për Pronësinë Industriale", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:

- nëpërmjet postës elektronike (e-mail) në adresën:
- nëpërmjet komunikimit (SMS, telefonatë) në numrin:
- nëpërmjet fax-it në numrin:

DPPI njofton se shënimi i të dhënave të mësipërme të kontaktit është vullnetar. DPPI do të ruajë këto të dhëna (në vijim të "Dhënat Personale"), që aplikanti dhe/ose personi i autorizuar (në vijim "Subjekti") kanë shënuar në këtë formular aplikimi. Të dhënat personale do të përpunohen e përdoren nga DPPI, në cilësinë e Kontrolluesit, apo nga persona të tretë të caktuar nga DPPI, në cilësinë e Përpunuesit, ekskluzivisht për të komunikuar me subjektin, për sa i përket procedurave të lidhura me këtë aplikim.

Të dhënat personale nuk do t'i kalohen një marrësi të tretë, pa pëlqimin paraprak të subjektit dhe nuk do t'inënshtrohen transferimit ndërkombëtar.

DPPI mund të përdorë herë pas here një nga format e mësipërme të komunikimit për të kontaktuar subjektin dhe për t'i dërguar informacione që mund të jenë në interes të tij/saj, të tilla si njoftime, ngjarje dhe/ose zhvillime ligjore në fushën e veprimtarisë së DPPI. DPPI do të ndalojë dërgimin e këtij informacioni nëse subjekti njofton shprehimisht me shkrim DPPI-në, se ai/ajo nuk dëshiron të kontaktohet më tej për të marrë informacione të tilla.

Subjekti ka të drejtën e aksesit, bllokimit, korrigjimit ose fshirjes së të dhënave personale që DPPI ka ruajtur në bazën e të dhënave, si dhe të kërkojë të ushtrorë cdo të drejtë tjetër që i njihet nga legjislacioni në fuqi "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe nga paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi jep pëlqimin që DPPI të ruajë, përpunojë e përdorë të dhënat personale të subjektit, në pajtim me kushtet e mësipërme. Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi gjithashtu deklaron nën përgjegjësinë e tij/saj se të dhënat e kontaktit si më sipër janë të dhënat e tij/saj, ose të një personi të tretë, që ka autorizuar nënshkruesin të kryejë këto veprime.

Nënshkrimi i Aplikantit

--

Data	Muaji					Viti	

# FAQE SHITESË



## FORMULAR APLIKIMI PËR DORËHEQJE NGA APLIKIMI/PATENTA



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

<b>Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:</b> Tel: +355 (0) 42236288 E-mail: mailinf@alpto.gov.al Web: www.dppm.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
<b>Shënim:</b> Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, <b>ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.</b>	Referenca: Data:

### SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI PARAQITËSIN E KËRKESËS/APLIKUESI

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Emri i Babait	<input type="text"/>	4. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	<input type="text"/>
5. Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>
7. Vendlindja	<input type="text"/>	8. Shtetësia	<input type="text"/>
9. Adresa	<input type="text"/>		
10. Qyteti	<input type="text"/>	11. Rrethi	<input type="text"/>
12. Kodi Postar	<input type="text"/>	13. Nr. Tel	<input type="text"/>
NËSE APLIKANTI ËSHTË PERSON JURIDIK			
14. Emri i kompanisë	<input type="text"/>	15. NUIS <i>Nr. unik i identifikimit të subjektit</i>	<input type="text"/>
16. Adresa	<input type="text"/>		

### SEKSIONI A1: INFORMACION SPECIFIK MBI PËRFAQËSUESIN/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Adresa	<input type="text"/>		
4. Nr. Telefoni	<input type="text"/>	6. Kodi i përfaqësuesit të autorizuar	<input type="text"/>

### SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

#### TË DHËNA LIDHUR ME PATENTËN

1. Numri i patentës	<input type="text"/>	3. Data e depozitimit	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>
2. Numri i aplikimit për patentë	<input type="text"/>		
4. Titulli i shpikjes	<input type="text"/>		

TË DHËNA LIDHUR ME PATENTËN

<b>5. Numri ndërkombëtar i patentës</b>	<input type="text"/>	<b>6 Data ndërkombëtare e aplikimit</b>	<input type="text"/>
<b>7. Numri ndërkombëtar i publikimit</b>	<input type="text"/>	<b>8. Data ndërkombëtare e publikimit</b>	<input type="text"/>
TARIFAT DHE MËNYRAT E PAGESËS			
<b>9. Totali i shumës së paguar</b>	<input type="text"/>	<b>10. Data e pagesës</b>	<input type="text"/>
<b>11. Lloji i pagesës</b>	<input type="text"/>		

SEKSIONI C: NËNSHKRIMI I APLIKUESIT OSE PËRFAQËSUESIT E TIJ

Shënim: Është përgjegjësi e nënshkruesit të kërkesës çdo mospërputhje e të dhënave të formularit me dosjen e paraqitur

**Shtojca I.** Formular i deklaramit të të dhënave personale.

Unë i/e nënshkruari(a) pranoj që DPPI mund të më kontaktojë nëpërmjet mjeteve vijuese të komunikimit, për çështje të lidhura procedurat të parashikuara në Ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për Pronësinë Industriale", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:

<input type="checkbox"/>	<b>nëpërmjet postës elektronike (e-mail) në adresën:</b>	<input type="text"/>
<input type="checkbox"/>	<b>nëpërmjet komunikimit (SMS, telefonatë) në numrin:</b>	<input type="text"/>
<input type="checkbox"/>	<b>nëpërmjet fax-it në numrin:</b>	<input type="text"/>

DPPI njofton se shënimi i të dhënave të mësipërme të kontaktit është vullnetar. DPPI do të ruajë këto të dhëna (në vijim "Të Dhënat Personale"), që aplikanti dhe/ose personi i autorizuar (në vijim "Subjekti") kanë shënuar në këtë formular aplikimi. Të dhënat personale do të përpunohen e përdoren nga DPPI, në cilësinë e Kontrolluesit, apo nga persona të tretë të caktuar nga DPPI, në cilësinë e Përpunuesit, ekskluzivisht për të komunikuar me subjektin, për sa i përket procedurave të lidhura me këtë aplikim.

Të dhënat personale nuk do t'i kalohen një marrësi të tretë, pa pëlqimin paraprak të subjektit dhe nuk do t'i nënshtrohen transferimit ndërkombëtar.

DPPI mund të përdorë herë pas here një nga format e mësipërme të komunikimit për të kontaktuar subjektin dhe për t'i dërguar informacione që mund të jenë në interes të tij/saj, të tilla si njoftime, ngjarje dhe/ose zhvillime ligjore në fushën e veprimtarisë së DPPI. DPPI do të ndalojë dërgimin e këtij informacioni nëse subjekti njofton shprehimisht me shkrim DPPI-në, se ai/ajo nuk dëshiron të kontaktohet më tej për të marrë informacione të tilla.

Subjekti ka të drejtën e aksesit, bllokimit, korrigjimit ose fshirjes së të dhënave personale që DPPI ka ruajtur në bazën e të dhënave, si dhe të kërkojë të ushtrojë çdo të drejtë tjetër që i njihet nga legjislacioni në fuqi "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe nga paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi jep pëlqimin që DPPI të ruajë, përpunojë e përdorë të dhënat personale të subjektit, në pajtim me kushtet e mësipërme. Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi gjithashtu deklaron nën përgjegjësinë e tij/saj se të dhënat e kontaktit si më sipër janë të dhënat e tij/saj, ose të një personi të tretë, që ka autorizuar nënshkruesin të kryejë këto veprime.

Nënshkrimi i Aplikantit	<input type="text"/>	<input type="text"/>
		Data Muaji Viti



# FAQE SHITESË



**FORMULAR APLIKIMI**  
PËR DORËHEQJE NGA APLIKIMI PËR MODEL PËRDORIMI



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

<b>Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:</b> Tel: +355 (0) 42236288 E-mail: mailinf@alpto.gov.al Web: www.dppm.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
<b>Shënim:</b> Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, <b>ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.</b>	Referenca: Data:

**SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI PARAQITËSIN E KËRKESËS/APLIKUESIT**

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Emri i Babait	<input type="text"/>	4. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	<input type="text"/>
5. Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>
7. Vendlindja	<input type="text"/>	8. Shtetësia	<input type="text"/>
9. Adresa	<input type="text"/>		
10. Qyteti	<input type="text"/>	11. Rrethi	<input type="text"/>
12. Kodi Postar	<input type="text"/>	13. Nr. Tel	<input type="text"/>
NËSE APLIKANTI ËSHTË PERSON JURIDIK			
1. Emri i Kompanisë	<input type="text"/>	2. NUIS <i>Nr. unik i identifikimit të subjektit</i>	<input type="text"/>
3. Adresa	<input type="text"/>		

**SEKSIONI A1: INFORMACION SPECIFIK MBI PËRFAQËSUESIN/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR**

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Adresa	<input type="text"/>		
4. Nr. Tel	<input type="text"/>	5. Kodi i përfaqësuesit të autorizuar	<input type="text"/>

**SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN**

**TË DHËNA LIDHUR ME MODELIN E PËRDORIMIT**

1. Numri i modelit	<input type="text"/>	2. Data e depozitimit	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>
3. Numri i aplikimit për model përdorimi	<input type="text"/>		
4. Titulli i shpjekjes	<input type="text"/>		

TË DHËNA LIDHUR ME MODELIN E PËRDORIMIT

1. Numri ndërkombëtar i modelit përdorimit	<input type="text"/>	2. Data ndërkombëtare e aplikimit	<input type="text"/>
3. Numri ndërkombëtar i publikimit	<input type="text"/>	4. Data ndërkombëtare e publikimit	<input type="text"/>
TARIFAT DHE MËNYRAT E PAGESËS			
5. Totali i shumës së paguar	<input type="text"/>	6. Data e pagesës	<input type="text"/>
7. Lloji i pagesës	<input type="text"/>		

SEKSIONI C: NËNSHKRIMI I APLIKUESIT OSE PËRFAQËSUESIT TË TIJ

Shënim: Është përgjegjesi e nënshkruesit të kërkesës çdo mospërputhje e të dhënave të formularit me dosjen e paraqitur

**Shtojca I.** Formulari i deklaramit të të dhënave personale.

Unë i/e nënshkruari(a) pranoj që DPPI mund të më kontaktojë nëpërmjet mjeteve vijuese të komunikimit, për çështje të lidhura me procedurat të parashikuara në Ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për Pronësinë Industriale", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:

<input type="checkbox"/>	nëpërmjet postës elektronike (e-mail) në adresën:	<input type="text"/>
<input type="checkbox"/>	nëpërmjet komunikimit (SMS, telefonatë) në numrin:	<input type="text"/>
<input type="checkbox"/>	nëpërmjet fax-it në numrin:	<input type="text"/>

DPPI njofton se shënimet e të dhënave të mësipërme të kontaktit është vullnetar. DPPI do të ruajë këto të dhëna (në vijim të "Dhënat Personale"), që aplikanti dhe/ose personi i autorizuar (në vijim "Subjekti") kanë shënuar në këtë formular aplikimi. Të dhënat personale do të përpunohen e përdoren nga DPPI, në cilësinë e Kontrolluesit, apo nga persona të tretë të caktuar nga DPPI, në cilësinë e Përpunuesit, ekskluzivisht për të komunikuar me subjektin, për sa i përket procedurave të lidhura me këtë aplikim.

Të dhënat personale nuk do t'i kalohen një marrësi të tretë, pa pëlqimin paraprak të subjektit dhe nuk do t'inënshtrohen transferimit ndërkombëtar.

DPPI mund të përdorë herë pas here një nga format e mësipërme të komunikimit për të kontaktuar subjektin dhe për t'i dërguar informacione që mund të jenë në interes të tij/saj, të tilla si njoftime, ngjarje dhe/ose zhvillime ligjore në fushën e veprimtarisë së DPPI. DPPI do të ndalojë dërgimin e këtij informacioni nëse subjekti njofton shprehimisht me shkrim DPPI-në, se ai/ajo nuk dëshiron të kontaktohet më tej për të marrë informacione të tilla.

Subjekti ka të drejtën e aksesit, bllokimit, korrigjimit ose fshirjes së të dhënave personale që DPPI ka ruajtur në bazën e të dhënave, si dhe të kërkojë të ushtrojë cdo të drejtë tjetër që i njihet nga legjislacioni në fuqi "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe nga paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi jep pëlqimin që DPPI të ruajë, përpunojë e përdorë të dhënat personale të subjektit, në pajtim me kushtet e mësipërme. Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi gjithashtu deklaron nën përgjegjësinë e tij/saj se të dhënat e kontaktit si më sipër janë të dhënat e tij/saj, ose të një personi të tretë, që ka autorizuar nënshkruesin të kryejë këto veprime.

Nënshkrimi i Aplikantit	<input type="text"/>	<input type="text"/>
		Data Muaji Viti

# FAQE SHITESË



**FORMULAR APLIKIMI**  
PËR KTHIMIN E APLIKIMIT PATENTË PËR SHPIKJE  
NË APLIKIM PËR MODEL PËRDORIMI  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË



<b>Nëse kenë pyetje, lutemi kontaktoni:</b> Tel: +355 (0) 42236288 E-mail: mailinf@alpto.gov.al Web: www.dppm.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
<b>Shënim:</b> Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, <b>ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.</b>	Referenca: Data:

**SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN**

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Emri i Babait	<input type="text"/>	4. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	<input type="text"/>
5. Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>
7. Qyteti	<input type="text"/>	8. Shtetësia	<input type="text"/>
9. Adresa	<input type="text"/>		
10. Kodi Postar	<input type="text"/>	11. Statusi Ligjor	<input type="text"/>
NËSE APLIKANTI ËSHTË PERSON JURIDIK			
12. Emri i kompanisë	<input type="text"/>	13. NUIS <i>Nr. unik i identifikimit të subjektit</i>	<input type="text"/>
14. Adresa	<input type="text"/>	15. Statusi Ligjor	<input type="text"/>

**SEKSIONI A1: INFORMACION SPECIFIK MBI PËRFAQËSUESIN/PËRFAQËSUES I AUTORIZUAR**

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Adresa	<input type="text"/>		
4. Kodi i përfaqësuesit	<input type="text"/>		

**SEKSIONI A2: INFORMACION SPECIFIK MBI SHPIKËSIN**

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Adresa	<input type="text"/>		
4. Kodi Postar	<input type="text"/>	5. Qyteti	<input type="text"/>
6. Adresa për korrespondencë	<input type="text"/>		
7. Nr. Tel	<input type="text"/>	8. Fax/ Email	<input type="text"/>
